



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 12 Prill 2021

Nr: 15

VENDIM

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 11, DATË 25.03.2021, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, “PËR MËNYRËN E NGRITJES, ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT DHE ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE NË QENDRËN E VOTIMIT”

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronjat “a” e “b”, dhe 3, neni 2, pika 3, neni 36 e vijues i ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një anëtari të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I

1. Në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në Qendrën e Votimit”, bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 e nenit 32 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Sekretari i KQV-së regjistron të dhënat e zgjedhësit në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Kryetari pasi verifikon informacionin me dokumentin e printuar nga PEI, dhënë nga Operatori teknik/personi i autorizuar nga KQZ, e administron atë dhe e fut në zarfin ku shënohet “VËRTETIME TË IDENTIFIKIMIT ELEKTRONIK TË ZGJEDHËSVE”.



Data: 12 Prill 2021

Nr. 15

Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 25.03.2021, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Iirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**

